

U D H Ë Z I M

për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillave Kombëtare të Pakicave Kombëtare¹

(teksti final)

Neni 1

(1) Ky udhëzim rregullon mënyrën e mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor në procedurën e zgjedhjeve për anëtarët e Këshillave Kombëtare të Pakicave Kombëtare.

(2) Kuvendi Zgjedhor zgjedh anëtarët e Këshillit Kombëtar nëse nuk janë plotësuar kushtet për zgjedhje të drejtpërdrejta për anëtarët e Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare dhe nëse në rast të shpërbërjes së Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare, zgjedhjet e reja thirren brenda 60 ditëve nga shpërbërja e Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare.

Neni 2

(1) Zgjedhjet në Kuvendin Zgjedhor i realizon këshilli prej tre anëtarësh, të cilët i emëron Komisioni Republikan Zgjedhor nga radhët e njohësve të procedurave zgjedhore (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(2) Komisioni Republikan Zgjedhor (në tekstin e mëtejme: Komisioni) i emëron anëtarët e Këshillit në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes së njoftimit nga Ministria në fushëveprimin e së cilës janë çështjet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: Ministria) se për Kuvendin Zgjedhor është konfirmuar numri i mjaftueshëm i elektorëve të përcaktuar me ligj.

(3) Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë kompensimi për punën në Këshill, shumën e së cilës e përcakton Komisioni.

(4) Kushtet e punës së Këshillit, duke përfshirë edhe mjetet për kompensim nga paragrafi 3 i këtij neni si dhe shpenzimet tjera të Këshillit i siguron Komisioni.

Neni 3

(1) Aktet zgjedhore të Kuvendit Zgjedhor evidentohen në librin e evidentimit të Komisionit.

(2) Aktet e Këshillit vërtetohen me vulën e Komisionit.

Neni 4

(1) Kuvendi Zgjedhor mbahet nëse Ministria ka konfirmuar numrin minimal të elektorëve të përcaktuar me ligj, përkatësisht:

1) të paktën 20 elektorë te pakicat kombëtare numri i të cilëve sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më pak se 10.000 persona;

2) të paktën 30 elektorë te pakicat kombëtare numri i të cilëve sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më pak se 20.000 persona;

3) të paktën 45 elektorë te pakicat kombëtare numri i të cilëve sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më shumë se 20.000 persona, por më pak se 50.000 persona;

¹ „Gazeta zyrtare e RS“, numër 106/22.

4) të paktën 60 te pakicat kombëtare numri i të cilëve sipas regjistrimit të fundit është më shumë se 50.000 persona, por më pak se 100.000 persona;

5) të paktën 100 te pakicat kombëtare numri i të cilëve sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më shumë se 100.000 persona.

(2) Në rast se nuk vërtetohet numri minimal i elektorëve nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria, 25 ditë para ditës së mbledhjes së Kuvendit Zgjedhor, nxjerr vendim për pezullimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, i cili botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Neni 5

Nëse Ministria ka konfirmuar numër të mjaftueshëm të elektorëve në kuptim të nenit 4 të këtij udhëzimi, d.m.th. nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor, për mbajtjen e zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit Kombëtar në Kuvendin Zgjedhor, është e nevojshme që në Kuvendin Zgjedhor të vijnë më së paku gjysma e zgjedhësve të konfirmuar dhe jo më pak se numri minimal nga neni 4 i këtij udhëzimi.

Neni

(1) Pas hapjes së Kuvendit Zgjedhor, Këshilli konstaton dhe shpall numrin e elektorëve prezent, në bazë të listës së elektorëve të cilëve u është konfirmuar kërkesa zgjedhore, të cilën Ministria ia ka dorëzuar Komisionit.

(2) Këshilli përcakton identitetin e elektorëve me verifikimin e letërnjoftimit të tyre.

(3) Përveç me anë të letërnjoftimit, identitetin e vet elektori mund ta vërtetojë edhe me dokument të vlefshëm udhëtimi (pasaportë).

(4) Elektorë i pranishëm konsiderohet elektori i cili vjen në Kuvendin Zgjedhor dhe prezencën e vet e regjistron deri në kohën e caktuar për fillimin e Kuvendit Zgjedhor.

(5) Pas konstatimit të numrit të elektorëve prezent, nuk është më e mundur të regjistrohet prezenca e elektorëve.

(6) Nëse nuk janë përmbushur kushtet për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor, në kuptim të numrit të nevojshëm të elektorëve prezent, Këshilli përmbyll Kuvendin Zgjedhor dhe menjëherë pas kësaj merr vendim për pezullimin e procedurës për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar.

(7) Në rast se janë të pranishëm një numër i mjaftueshëm elektorësh, Këshilli konstaton se janë përmbushur kushtet për të porceduar me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe shpall numrin e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar që do të zgjidhen dhe numrin më të vogël të elektorëve të cilët mund të propozojnë listën e kandidatëve. Pas kësaj, Këshilli fton elektorët që të dorëzojnë listat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe përcakton pauzë për propozimin e listës së kandidatëve.

(8) Pauza për propozimin e listës së kandidatëve nuk mund të zgjasë më gjatë se katër orë.

Neni 7

(1) Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: Lista e kandidatëve) mund të propozohet nga të paktën një e katërta e elektorëve të pranishëm.

(2) Lista e kandidatëve dorëzohet në formularin të cilin e përcakton Komisioni, sipas drejtshkrimit serb. Emri dhe mbiemri i kandidatit mund të radhiten sipas drejtshkrimit dhe shkrimit të pakicës kombëtare.

(3) Në listën e kandidatëve duhet të gjendet të paktën një e treta e kandidatëve nga numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjidhet, dhe më së shumti aq kandidatë sa është numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar që do të zgjidhen.

(4) Në listën e kandidatëve duhet të caktohet elektori i cili është bartës i listës së kandidatëve.

(5) Bartësi i listës së kandidatëve konsiderohet përfaqësuesi i propozuesit të listës së kandidatëve.

(6) Në listën e kandidatëve duhet të jetë së paku një kandidat në mesin e çdo tre kandidatëve sipas radhës në listë (tre vendet e para, tre vendet e dyta, e kështu me radhë deri në përfundim të listës) - anëtar i gjinisë që është më pak e përfaqësuar në listë.

(7) Elektori mund të marrë pjesë në propozimin e vetëm një liste kandidatësh.

(8) Nëse elektori i njëjtë është në mesin e propozuesve të disa listave të kandidatëve, do të konsiderohet se ka marrë pjesë në propozimin e listës së kandidatëve të paraqitur më herët.

Neni 8

(1) Kandidat për anëtar të Këshillit Kombëtar në listën e kandidatëve mund të jetë elektori ose votuesi i regjistruar në listën e posaçme zgjedhore të Pakicës Kombëtare, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.

(2) Nëse në listën e kandidatëve gjendet votuesi ose elektori i cili nuk konsiderohet i pranishëm në kuptim të nenit 6 paragrafi 5 të këtij udhëzimi, listës së kandidatëve i bashkëngjitet deklarata e vërtetuar e votuesit respektivisht elektorit për pranimin e kandidaturës për anëtar të Këshillit Kombëtar, në formularin e përcaktuar nga Komisioni. Me këtë deklaratë, votuesi, përkatësisht elektori, pranon që një elektorë i caktuar ta përfshijë atë në Listën e kandidatëve në emërimin e të cilëve merr pjesë ai elektorë.

(3) Elektorët të cilët konsiderohen të pranishëm në kuptim të nenit 6 paragrafi 5 i këtij udhëzimi nuk dorëzojnë deklaratë për pranimin e kandidaturës, por nënshkrimi i tyre nga propozuesit e listës së kandidatëve konsiderohet pranim i kandidaturës.

(4) Nëse në listën e kandidatëve ka një elektorë që konsiderohet i pranishëm dhe nuk është nënshkruar si një nga propozuesit e listës së kandidatëve, do të konsiderohet se lista e kandidatëve përmban një mangësi që është pengesë për shpalljen e saj.

Neni 9

(1) Pas përfundimit të pauzës së caktuar për propozimin e listave të kandidatëve, Këshilli konstaton numrin e listave të dorëzuara të kandidatëve dhe me atë rast shpall emrat e kandidatëve sipas listave të kandidatëve, si dhe emrat e elektorëve që kanë mbështetur secilën nga listat e kandidatëve. Bordi më pas fton elektorët e pranishëm që të paraqesin vërejtjet eventuale ndaj listave të paraqitura të kandidatëve.

(2) Nëse nuk është paraqitur asnjë listë e kandidatëve, Këshilli përmbyll Kuvendin Zgjedhor dhe menjëherë merr vendimin për pezullimin e procedurës për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar.

(3) Nëse është paraqitur të paktën një listë kandidatësh, Këshilli cakton një pauzë për verifikimin e plotësimit të kushteve që listat e paraqitura të kandidatëve të shpallen.

(4) Në procedurën e verifikimit nga paragrafi 3 i këtij neni, Këshillit i ofron ndihmë përfaqësuesi i Ministrisë kompetente për udhëheqjen e listës së posaçme zgjedhore të Pakicës Kombëtare, për të verifikuar nëse kandidatët për antëarë të Këshillit Kombëtar janë regjistruar në listën e posaçme zgjedhore të Këshillit Kombëtar, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.

Neni 10

(1) Pas verifikimit të listave të paraqitura të kandidatëve, Këshilli njofton se cila listë e kandidatëve plotëson, respektivisht nuk plotëson kushtet për shpallje.

(2) Pas shpalljes nga paragrafi 1 i këtij neni, më nuk është e mundur të tërhiqet kandidatura, respektivisht nënshkrimi i mbështetjes për listën e kandidatëve.

Neni 11

(1) Në rast se ndonjëra nga listat e kandidatëve përmban një mangësi për shpallje (listën e kandidatëve nuk e ka propozuar numër i mjaftueshëm i elektorëve, lista e kandidatëve nuk plotëson kushtet në pikëpamje të numrit të kandidatëve dhe/ose përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar në listën e kandidatëve, nuk është dorëzuar deklaratat e vërtetuar e votuesve, respektivisht elektorëve që pranon kandidaturën, ose deklaratat e dërguar nuk është plotësuar dhe/ose nuk është vërtetuar siç duhet, ose kandidati i propozuar nuk është regjistruar në listën e posaçme zgjedhore të pakicës kombëtare Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet, ose në listën e kandidatëve gjendet elektori i cili konsiderohet prezent dhe nuk është në mesin e propozuesve të listës së kandidatëve), Këshilli me konkluzion urdhëron bartësin e listës së kandidatëve që në afat prej një ore të eliminojë mangësitë e konstatuara.

(2) Mangësitë e listës zgjedhore eliminohen duke plotësuar listën e elektorëve të cilët propozojnë listën e kandidatëve, përmes plotësimit të listës së kandidatëve deri në numrin e duhur të kandidatëve, përmes ndryshimit të radhitjes së kandidatëve ose listës së kandidatëve, ose përmes tërheqjes së kandidatëve nga lista e kandidatëve.

(3) Pas skadimit të afatit për eliminimin e mangësive, Këshilli konstaton nëse bartësi i listës së kandidatëve ka vepruar sipas konkluzionit për eliminimin e mangësive dhe merr vendim për shpalljen e listës së kandidatëve ose vendimin për refuzimin e saj.

Neni 12

(1) Këshilli shpall listat e kandidatëve të cilat plotësojnë kushtet për shpallje, sipas radhitjes së paraqitjes së tyre dhe për këtë merr vendim me të cilin përcakton numrin rendor të secilës nga listat e kandidatëve.

(2) Me rastin e shpalljes së listës së kandidatëve, Këshilli njofton për emrat e kandidatëve nga lista e kandidatëve.

(3) Pas shpalljes së listës së kandidatëve, nuk mund të bëhet më tërheqja e saj.

Neni 13

Nëse numri i kandidatëve në listat e shpallura të kandidatëve është më i vogël se numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjidhet, Këshilli përmbyll Kuvendin Zgjedhor dhe menjëherë pastaj merr vendim për pezullimin e procedurës së zgjedhjes së Këshillit Kombëtar.

Neni 14

Nëse nuk shpallet asnjë listë e kandidatëve, Këshilli përmbyll Kuvendin Zgjedhor dhe menjëherë pastaj merr vendim për pezullimin e procedurës së zgjedhjes së Këshillit Kombëtar.

Neni 15

Pas përfundimit të procedurës së shpalljes së listës së kandidatëve, të gjithë bartësit e listave të kandidatëve, ose personat e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë t'i drejtohen Kuvendit Zgjedhor, me paraqitje deri në dhjetë minuta, sipas rendit të shpalljes së listave të kandidatëve.

Neni 16

(1) Pas fjalimeve të bartësve të listave të kandidatëve, fillon votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

(2) Të drejtë vote kanë elektorët që konsiderohen të pranishëm në kuptim të nenit 6 paragrafi 5 i këtij udhëzimi.

(3) Këshilli me ftesë fton elektorët që të marrin fletëvotimin.

(4) Para marrjes së fletëvotimit, elektori nënshkruhet në katrorin përkatës të evidencës për elektorët prezent, si dëshmi se e ka pranuar fletëvotimin.

(5) Kuvendi i Elektorëve zgjedh anëtarët e Këshillit Kombëtar me aplikimin e sistemit proporcional, duke votuar për listat e kandidatëve.

(6) Votimi zgjat deri sa të votojnë elektorët prezent me të drejtë vote, kurse më së shumti 120 minuta.

(7) Votimi bëhet i fshehtë, në fletëvotimet e përgatitura sipas formularit të cilin e përcakton Komisioni.

(8) Numri i fletëvotimeve të cilat shtypen është i njëjtë me numrin e elektorëve të konfirmuar.

(9) Vendimet për përcaktimin e numrit ose ngjyrës së fletëvotimeve të printuara publikohen nga Komisioni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

(10) Fletëvotimet i vërteton Komisioni.

(11) Për votim përdoret kutia e votimit dhe paravanet për sigurimin e fshehtësisë së votës, të bërë sipas Udhëzimit për standardet uniforme të materialeve zgjedhore ("Gazeta Zyrtare e RS", numër 19/22).

(12) Votohet vetëm për një listë të kandidatëve, duke shënuar emrin e bartësit, respektivisht numrin e listës së kandidatit në fletëvotim.

(13) Fletëvotimi nga i cili nuk mund të vërtetohet me siguri për kë është votuar do të konsiderohet i pavlefshëm.

Neni 17

(1) Menjëherë pas përfundimit të votimit, Këshilli fillon me vërtetimin e rezultateve të votimit.

(2) Të drejtë të marrin pjesë në vërtetimin e rezultateve të votimit kanë të gjithë elektorët prezent në kuptim të nenit 6 paragrafi 5 i këtij udhëzimi.

Neni 18

(1) Vërtetimi i rezultateve të zgjedhjeve përfshin: vërtetimin e numrit të elektorëve të cilët marrin pjesë në Kuvendin Zgjedhor, sipas evidencës së pjesëmarrjes, numrit të elektorëve të cilët kanë marrë fletëvotimin, numrit të fletëvotimeve që gjenden në kutinë e votimit, numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, numrit të fletëvotimeve të vlefshme, numrit të votave që i takojnë çdo liste të kandidatëve dhe numrit të mandateve të cilët i takojnë secilës listë të kandidatëve.

(2) Përpunimin statistikor të rezultateve të votimit e bën përfaqësuesi i Entit Republikan për Statistika.

Neni 19

(1) Këshilli ndanë mandatet e anëtarëve të Këshillit Kombëtar duke përdorur sistemin e herësit më të lartë (sistemi i D`Ontit).

(2) Mandatet ndahen ashtu që numri i përgjithshëm i votave që ka marrë çdo listë e kandidatëve, pjesëtohet me numrat nga një duke përfunduar me numrin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjidhet.

(3) Herësat e fituara klasifikohen sipas madhësisë, kurse merren parasysh aq herësa më të mëdha, sa anëtarë të Këshillit Kombëtar zgjidhen.

(4) Nëse dy ose më shumë lista të kandidatëve fitojnë herësa të njejta në bazë të së cilave ndahet një mandat, kurse nuk ka më mandate të pashpërndara, mandati do të ndahet listës së kandidatëve e cila ka marrë numër më të madh të votave.

(5) Kur listës së kandidatëve i takojnë më shumë mandate se sa që ka kandidatë në të për anëtar të Këshillit Kombëtar, mandati i ndahet listës së kandidatëve e cila ka herësin e radhës më të lartë.

Neni 20

(1) Menjëherë pas vërtetimit të rezultateve të votimit, Këshilli përgatit procesverbalin e punës për Kuvendin Zgjedhor në formularin të cilin e cakton Komisioni.

(2) Në procesverbalin e punës për Kuvendin Zgjedhor shënohen vërejtjet e bartësve të listave të kandidatëve dhe elektorëve të cilët nuk kanë marrë pjesë në propozimin e listës së kandidatëve.

(3) Procesverbalin për punën në Kuvendin Zgjedhor e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e Këshillit dhe të gjithë bartësit e listave të kandidatëve.

(4) Nëse ndonjëri nga bartësit e listave të kandidatëve nuk ka dashur të nënshkruajë procesverbalin e punës në Kuvendin Zgjedhor, kjo konstatohet në procesverbal.

(5) Të drejtë për kopjen e procesverbalit të punës për Kuvendin Zgjedhor, të vërtetuar me vulën e Komisionit, e kanë të gjithë bartësit e listave të kandidatëve.

Neni 21

Kuvendi Zgjedhor përfundon me dorëzimin e kopjeve të procesverbalit të punës në Kuvendin Zgjedhor.

Neni 22

(1) Pas përfundimit të Kuvendit Zgjedhor, Këshilli nxjerr vendim për rezultatet e votimit, i cili përmban të dhënat nga neni 18 i këtij udhëzimi.

(2) Vendimi për rezultatet e votimit botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Neni 23

(1) Mandatet të cilat i përkasin listës së kandidatëve u caktohen kandidatëve sipas radhitjes së tyre në listën e kandidatëve, duke filluar nga kandidati i parë.

(2) Mandatet e anëtarëve të Këshillit Kombëtar caktohen nga Këshilli brenda tri ditëve nga vërtetimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

(3) Vendimin për ndarjen e mandateve të anëtarëve të Këshillit Kombëtar, Këshilli ia dorëzon Ministrisë dhe e publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

(4) Kandidatëve të cilëve u janë ndarë mandatet e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, Këshilli u lëshon vërtetim për zgjedhjen për anëtar të Këshillit Kombëtar.

Neni 24

(1) Kundër çdo vendimi të Këshillit, elektori mund të paraqesë ankesë pranë Komisionit brenda tre orëve nga marrja e vendimit.

(2) Komisioni vendos për ankesën në afat prej 12 orëve nga pranimi i ankesës.

(3) Kundër vendimit të Komisionit mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Administrative në afat prej tre orëve nga pranimi i vendimit, kurse Gjykata Administrative vendos brenda 12 orëve.

Neni 25

(1) Dispozitat e ligjit që rregullojnë zgjedhjen e deputetëve për vëzhgimin e punës së organit zbatues të zgjedhjeve zbatohen në përputhje me rrethanat për regjistrimin e vëzhguesve vendas dhe të huaj në Kuvendin Zgjedhor.

(2) Komisioni me akt të veçantë përcakton formularët për paraqitjen e kërkesave për vëzhgimin e punës në Kuvendin Zgjedhor.

(3) Nëse zgjedhjet përmes Kuvendit Zgjedhor mbahen në të njëjtën kohë me zgjedhjet e drejtpërdrejta për anëtarët e Këshillave Kombëtare të Pakicave Kombëtare, formularët e përcaktuar në përputhje me udhëzimet për realizimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarët e Këshillave Kombëtare të Pakicave Kombëtare përdoren për regjistrimin e vëzhguesve vendor dhe të huaj të punës në Kuvendin Zgjedhor.

(4) Në rastin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, përfaqësuesit e vëzhguesve të cilëve Komisioni i ka lejuar vëzhgimin e punës së Komisionit në realizimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Kombëtare, kanë të drejtë të monitorojnë punën e Kuvendit Zgjedhor pa bërë aplikim të posaçëm te Komisioni, me obligim të mbajtjes së akreditimit përkatës.

Neni 26

(1) Komisioni, me vendim të veçantë, përcakton formularët për kryerjen e veprimeve zgjedhore të përcaktuara me ligj dhe me këtë udhëzim.

(2) Teksti i formularëve për paraqitjen e listës së kandidatëve, teksti i fletëvotimit, teksti i procesverbalit të punës në Kuvendin Zgjedhor dhe teksti i certifikatës për zgjedhjen për anëtar të Këshillit Kombëtar të Pakicave Kombëtare do të shtypen në gjuhën serbe, në shkrimin cirilik.

(3) Nëse në Kuvendin Zgjedhor zgjidhen anëtarë të Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare, gjuha dhe shkrimi i të cilëve janë në përdorim zyrtar në të paktën një njësi të vetëqeverisjes lokale, tekstet e materialeve nga paragrafi 2 i këtij neni, me përjashtim të procesverbalit të punës në Kuvendin Zgjedhor, shtypen në dy gjuhë, gjegjësisht edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, duke shtypur tekstin në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare nën tekstin në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik në të njëjtën formë dhe me të njëjtën madhësi fonti.

Neni 27

Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".